



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK**

Nr.1344/9 prot.

Datë20.05.2026

**V E N D I M**  
**Nr.682/2026**

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Fiorent Zguro	Nënkryetar
Anila Malaj	Anëtar
Gjergj Mersini	Anëtar

Në mbledhjen e dates 20.05.2026, mori në shqyrtim çështjen me,

- Objekt:** Mbi zbatimin e vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 628/2026, datë 12.05.2026 për procedurën e prokurimit “E hapur, e thjeshtuar”, me Nr. REF-83467-04-27-2026, me objekt “Mirëmbajtja e Sistemit të taksave dhe implementim të paketës shtesë “Sistem i ndërveprimit me e-albania” për Bashkinë Krujë”, me fondi limit 1,666,000.00 pa TVSH parashikuar për tu zhvilluar më datë 08.05.2026, nga autoriteti kontraktor, Bashkia Kruje
- Ankimues:** Operatori ekonomik “Idealdevs Corporation” SHPK me NIPT M38106801F dhe adresë: BARAJ 01960008 Nd. 64, H. 1., Mallakastër
- Autoriteti Kontraktor:** Bashkia Kruje me adresë: Kruje Qender, sheshi “Mustafa Merlika (Kruja)”
- Baza Ligjore:** Ligji nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik, i ndryshuar, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik nr.766/2021, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funksonimin e Komisionit të Prokurimit Publik”

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi shqyrtoi dokumentacionin e çështjes dhe e diskutoi në tërësi,

## Vëren:

### I

#### *Rrethanat e çështjes*

I.1. Në datë 12.05.2026, Komisioni i Prokurimit Publik mori vendimin Nr.628/2026, ku vendosi:

- 1. Të mbyllë çështjen për ankesën e paraqitur nga operatori ekonomik “Idealdevs Corporation” SHPK për procedurën e prokurimit “E hapur, e thjeshtuar”, me Nr. REF-83467-04-27-2026, me objekt “Mirëmbajtja e Sistemit të taksave dhe implementim të paketës shtesë “Sistem i ndërveprimit me e-albania” për Bashkinë Krujë”, me fondi limit 1,666,000.00 pa TVSH parashikuar për tu zhvilluar më datë 08.05.2026, nga autoriteti kontraktor, Bashkia Kruje.*
- 2. Autoriteti kontraktor të publikojë shtojcën për ndryshimin e dokumentave të tenderit në përputhje me vendimin e KSHA nr.199, datë 05.05.2026 “Për shyrtimin e ankesës së operatorit ekonomik “Idealdevs Corporation” SHPK.*
- 3. Autoriteti kontraktor brenda 5 ditëve, të vërë në dijeni Komisionin e Prokurimit Publik për zbatimin e vendimit duke dokumentuar veprimet e kryera.*
- 4. Ngarkohet zyra e financës, që të bëjë kthimin e tarifës financiare të paguar nga operatori ekonomik “Idealdevs Corporation” SHPK.*
- 5. Kopje e këtij vendimi ti dërgohet Agjencisë së Prokurimit Publik.*

*Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.*

I.2. Me shkresën nr.3680 prot., datë 14.05.2026, protokolluar me tonën nr. 1344/6 prot., datë 19.05.2026, autoriteti kontraktor, njofton se ka zbatuar vendimin Nr.628/2026, datë 12.05.2026, të Komisionit të Prokurimit Publik.

### II

#### **Komisioni i Prokurimit Publik**

Pasi shqyrtoi dokumentacionin e mësipërm,

#### **Arsyeton:**

II.1. Me shkresën nr.3680 prot., datë 14.05.2026, protokolluar me tonën nr. 1344/6 prot., datë 19.05.2026, autoriteti kontraktor, njofton se ka zbatuar vendimin Nr.628/2026, datë 12.05.2026, të Komisionit të Prokurimit Publik.

II.2. Referuar shkresës së mësipërme, të dorëzuar nga autoriteti kontraktor pranë Komisionit të Prokurimit Publik, si dhe verifikimeve të kryera në Sistemin e Prokurimeve Elektronike, konstatohet, se autoriteti kontraktor ka publikuar shtojcën për modifikimin e dokumenteve të tenderit të procedurës së mësipërme të prokurimit, e cila është në përputhje me vendimin e KSHA së autoritetit kontraktor i cili ka pranuar plotësisht ankesën dhe mbi bazën e tij KPP me vendimin nr. 628/2026 datë 12.05.2026 ka mbyllur çështjen.

II.3. Sa më sipër KPP konsaton se autoriteti kontraktor ka zbatuar vendimin e KSHA së autoritetit kontraktor i cili ka pranuar plotësisht ankesën dhe mbi bazën e tij KPP me vendimin nr. 628/2026 datë 12.05.2026 ka mbyllur çështjen për procedurën e prokurimit “E hapur, e thjeshtuar”, me Nr. REF-68750-11-13-2025, me objekt “Loti 6 Progesteron vaginal i micronizuar”, me fondi limit 482,964.00 pa TVSH parashikuar për tu zhvilluar më datë 26.11.2025, nga autoriteti kontraktor, Operatori i Blerjeve te Perqendruara.

Për sa më sipër, në mbështetje të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, Vendimin e Komisionit të Prokurimit Publik nr.766/2021, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri,

### **Vendos**

1. Të lejojë autoritetin kontraktor për vijimin me hapat e mëtejshëm të procedurës së prokurimit “E hapur, e thjeshtuar”, me Nr. REF-83467-04-27-2026, me objekt “Mirëmbajtja e Sistemit të taksave dhe implementim të paketës shtesë “Sistem i ndërveprimit me e-albania” për Bashkinë Krujë”, me fondi limit 1,666,000.00 pa TVSH parashikuar për tu zhvilluar më datë 08.05.2026, nga autoriteti kontraktor, Bashkia Kruje.
2. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.  
Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

### **KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK**

**Anëtar**  
**Anila Malaj**

**Anëtar**  
**Gjergj Mersini**

**Nënkryetar**  
**Fiorent Zguro**



Vulosur elektronikisht nga Komisioni i  
Prokurimit Publik  
Date:2026/05/21 14:43:09 +02'00'  
15e49fa42f124ce2bd370779733adde6

Digitally signed by  
Fiorent ZGURO  
Date: 2026.05.21  
03:14:56